



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 159/14  
Nr. i fq. / Br. st - 2 -  
Data: / Datum 31.07.2014

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

## PROCESVERBAL

**Nga mbledhja e I-rë e jashtëzakonshme (gjegjësisht e VII-të me radhë për vitin 2014) e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 17.07.2014**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit komunal, duke filluar në orën **10:07**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Ismet Gashi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Krustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Xhevahire Selmani, dhe Zoran Rakiç.

Munguan: Ergin Sunguri, Tasim Gubetini, anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe propozoi këtë rend dite: Shqyrtimi i rishikimit të buxhetit për vitin 2014.

**Kuvendi me vota unanime miratoi këtë:**

### REND DITE

#### 1. Shqyrtimi i rishikimit të buxhetit për vitin 2014.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-** paraqiti sqarime hyrëse lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2014.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar tabelës 4.2 të rishikimit të buxhetit tek pozicioni “Rregullimi i rrugëve të rendit të IV-të”, ku janë paraparë 38.000 €, propozoi që nga kjo shumë të hiqen 11.000 € për t’u destinuar në ndërtimin e rrugës Gllavotin – Bivolak, pasi që rruga në fjalë ka mbetur e papërfunduar.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së** - lidhur me pozicionin “Rregullimi i rrugëve të rendit të IV-të”, sqaroi se MPMS-ja në vitin e kaluar ia ka ndarë Komunës së Vushtrrisë 30.000 € për ndërtimin e rrugëve të rendit të IV-të, por marrëveshja në fjalë nuk është realizuar në fillim të vitit.

**Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës** - lidhur me pozicionin “Rregullimi i rrugëve të rendit të IV-të”, sqaroi se MPMS-ja në vitin e kaluar ia ka ndarë Komunës së

Vushtrrisë 30.000 € për ndërtimin e rrugëve të rendit të IV-të, por marrëveshja në fjalë nuk është realizuar në fillim të vitit, kurse komuna ka hyrë në obligime, prandaj obligimet në fjalë mbulohen me mjetet e parapara prej 38.000 €.

**Ismet Gashi, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar rishikimit të buxhetit për vitin 2014, lidhur me 15 %-shin prej mallrave, shërbimeve dhe shpenzimeve komunale, pyeti se a do të zbritet prej shumës së përgjithshme apo prej mjeteve që kanë mbetur pa u shfrytëzuar? Pastaj tha se në materialin për mbledhjen e KPF-së lidhur me pozicionin "Shërbime publike, mbrojtje civile dhe emergjencë" në KPF kanë qenë 46.000 euro mallra dhe shërbime, kurse në materialin për mbledhjen e KK-së nuk figuron fare, prandaj pyeti pse është hequr?

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së** - lidhur me pyetjet e I.Gashit, u përgjigj se 15 %-shi zbritet nga shuma e përgjithshme. Po ashtu sqaroi se në Drejtorinë për Shërbime Publike, në mbledhjen e KPF-së ka qenë shuma prej 46.000 €, duke shtuar se nuk ka nevojë të prezantohet në tabelar, për shkak se nga ky program nuk do të merren mjetet në fjalë, por do të shfrytëzohen për mirëmbajtjen dhe pastrimin e shkollave të mesme.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** - duke iu referuar tabelës 4.2 tha se inventari për shkollën e fshatit Pestovë ka ardhur nga ministria, prandaj shuma e paraparë për inventarin e shkollës në fshatin Pestovë propozoi që të destinohet e tëra (shuma prej 9.950 €) për ndërtimin e rrethojës në shkollën e fshatit Pestovë, pasi që shuma prej 2.500 € nuk mjafton për ndërtimin e rrethojës në fjalë.

**Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së** - duke iu referuar kërkesës së kryesuesit të kuvendit të komunës, tha se gjatë këtij viti Drejtoria për Arsim ka pasur shumë ankesa nga inspektorët për gjendjen e rëndë të inventarit në shkolla, prandaj Drejtoria për Arsim ka vlerësuar se është më me prioritet që mjetet në fjalë të shfrytëzohen për inventar sesa për rrethojë të shkollës, duke shtuar se për vitin e ardhshëm përmes planifikimit do të realizohet ndërtimi i rrethojës për shkollën në fshatin Pestovë.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** - tha se pasi që është ndërtuar shkolla e re në fshatin Pestovë, më mirë është që mjetet të destinohen për ndërtimin e rrethojës së shkollës në fjalë, në mënyrë që të ruhet nga dëmtimet eventuale.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** - mbështeti propozimin e Drejtorisë për Arsim që mjetet në fjalë të shpenzohen për inventar të shkollave, pasi që gjendja e inventarit në shkolla nuk është e mirë.

**Lidhur me propozimin e kryesuesit të kuvendit të komunës, Kuvendi pas votimit me 21 vota "për", 1 "kundër", të tjerat "abstenim", vendosi me sa vijon:**  
**Shuma e mjeteve prej 9.950 € destinohen për ndërtimin e rrethojës për shkollën në fshatin Pestovë.**


**Në fund të diskutimit lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2014, Kuvendi pas votimit me 32 vota "për" 1 "kundër", vendosi me sa vijon:**

**Me këtë vendim bëhet rishikimi i mjeteve të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2014, në bazë të Ligjit të Buxhetit për vitin 2014 të MEF-it, dhe kërkesave të programeve buxhetore të komunës.**

**Mjetet e rishikuara barten sipas tabelave standarde 4.1 dhe 4.2, që janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.**

**Mbledhja përfundoi në orën 10:35.**

**Procesmbajtësi**

  
**Alban Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Shpëtim Zhegrova**  
